



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 138, datë 16.04.2020

MBI
MIRATIMIN E FONDEVE TË LIRA, NGA BUXHETI I VITIT 2020, NË SISTEMIN
GJYQËSOR,

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave, kërkesës së Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit, në Këshillin e Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I:

1. Miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit ushtrimor 2020, në programin 01110, “Planifikim, Menaxhim, Administrim” buxheti i KLGJ-së, për shumën prej 23 000 000 (njëzetë e tre milion) lekë, sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur.
2. Miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit ushtrimor 2020, në programin 03310, “Buxheti gjyqësor” buxheti i Gjykatave, për shumën prej 52 984 000 (pesëdhjetë e dy milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë, sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur.
3. Fondet e lira të miratuara, t’i dërgohen në dispozicion Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të rishikimit të Buxhetit të Shtetit, për shkak të situatës së krijuar nga epidemia e virusit Covid-19.
4. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Pasqyra e fondeve të lira të miratuara, nga programi 01110, buxheti i KLGJ-së.

000/lek

<i>Kodi i institucionit</i>	<i>Emërtimi i programit</i>	<i>Programi buxhetor</i>	<i>Llogaria ekonomike</i>	<i>Shuma e fondit për pakësim</i>	<i>Emërtimi i shpenzimit</i>
1029001	Planifikim, Menaxhim, Administrim	01110	600.9999	10,000	Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore personeli
1029001	Planifikim, Menaxhim, Administrim	01110	602.0000	0	Shpenzime për mallra dhe shërbime
1029001	Planifikim, Menaxhim, Administrim	01110	231.0000	13,000	Shpenzime për investime
	Totali			23,000	

Pasqyra nr. 2

Pasqyra e fondeve të lira të miratuara, nga programi 03310, buxheti i Gjykatave.

000/lek

<i>Kodi i institucionit</i>	<i>Emërtimi i programit</i>	<i>Programi buxhetor</i>	<i>Llogaria ekonomike</i>	<i>Shuma e fondit për pakësim</i>	<i>Emërtimi i shpenzimit</i>
1029001	Buxheti i Gjykatave	03310	600.9999	52,984	Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore personeli
1029001	Buxheti i Gjykatave	03310	602.0000	0	Shpenzime për mallra dhe shërbime
1029001	Buxheti i Gjykatave	03310	231.0000	0	Shpenzime për investime
	Totali			52,984	